



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 26.10.2020

### R A P O R T

#### PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2020”

##### **I. Hyrje.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 26 tetor 2021, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2020”.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore, për këtë projektligj, znj. Anila Denaj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar.

*Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:*

- Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre;
- Znj. Mimoza Dhemb, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;
- Z. Endrit Lami, Drejtor i Drejtorisë së Analizave Makroekonomike dhe Statistikave;
- Z. Gentian Opre, Drejtor i Drejtorisë së Analizës së Programimit Buxhetor.

*Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit:*

- Z. Arben Shehu, Kryetar;
- Znj. Mariola Llanaj, Drejtore e Përgjithshme;
- Z. Gjovalin Preçi, Sekretar i Përgjithshëm;
- Znj. Valbona Gaxha, Drejtore e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit;
- Z. Rigels Guzi, Auditues i Lartë;
- Z. Altin Shegani, Këshilltar i Kryetarit.

## **II. Baza ligjore.**

Shqyrtimi i projektligjit për miratimin e buxhetit faktik të vitit të mëparshëm është një procedurë e konsoliduar ndër vite, e cila mbështetet në:

- nenet 158 dhe 164 të Kushtetutës;
- nenin 63 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- nenin 31 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar;
- ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës.

## **III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit.**

Qëllimi i projektligjit është miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin 2020. Ky raport përmban informacione, statistika dhe analiza të detajuara mbi pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, zbatimin e buxhetit vjetor, borxhin publik dhe përbërjen e tij, përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës, si dhe situatën e kontrollit të brendshëm publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Projektligji dhe Raporti i Këshillit të Ministrave shoqërohen me Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2020, i cili pasqyron opinionin e këtij institucioni për përputhshmërinë e hartimit, zbatimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit, si dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Raporti i KLSH përmban një analizë të hollësishme të situatës makroekonomike e fiskale të vitit të mëparshëm, buxhetit vjetor, borxhit publik, si dhe përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Opinionin e KLSH bazohet në gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga KLSH në institucionet e qeverisjes qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe njësitë e tjera publike. Ky raport pasqyron edhe masat dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

#### **IV. Diskutimi në Komision.**

Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, paraqiti projektligjin, duke u ndalur në realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e fiskalë gjatë vitit 2020.

Z. Arben Shehu, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, paraqiti raportin e këtij institucioni mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2020.

Më pas, përfaqësuesit e këtyre institucioneve iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve.

Znj. Anila Denaj, në cilësinë e relatores, paraqiti opinionin e saj për projektligjin dhe për realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e fiskalë për vitin 2020. Ajo theksoi se viti 2020 ishte një vit sfidues për ekonominë shqiptare, i ndikuar nga pasojat e goditjeve të dy fatkeqësive natyrore: pandemisë shëndetësore Covid-19 dhe tërmetit të datës 26 nëntor 2019.

Pandemia Covid-19 është sfida më serioze ekonomike, me të cilën vendi ynë është përballur gjatë dy dekadave të fundit. Për të lehtësuar efektet negative imediate të krizës, si dhe për të kufizuar ndikimin afatgjatë të saj në ekonomi, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi ndërmorën një sërë masash të jashtëzakonshme kufizuese e stimuluese.

Masat kufizuese shtetërore dhe tkurrja e ekonomisë së vendeve të rajonit e të BE-së, me të cilat vendi ynë ka marrëdhënie ekonomike, ishin faktorët kryesorë që ndikuan negativisht në ekonomi.

Më tej, relatorja paraqiti disa nga karakteristikat kryesore të situatës ekonomike e buxhetore për vitin 2020, si më poshtë:

***Së pari, zhvillimet ekonomike dhe performanca në treguesit kyç ishin disa herë më të mirë se parashikimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.***

FMN parashikoi një reduktim të rritjes ekonomike me (- 7.5) për qind dhe, më vonë, e rishikoi këtë parashikim me reduktim (-3.5) për qind brenda vitit të mëparshëm, duke iu afruar kështu rezultatit përfundimtar të rritjes ekonomike për vitin 2020, prej (-3.31) për qind. Ky reduktim ishte i ndjeshëm në krahasim me një vit më parë, kur u arrit një rritje ekonomike pozitive prej 2.1 për qind.

Ekonomia shqiptare reagoi pozitivisht që në tremujorin e tretë të vitit. Ky reagim ishte rezultat

jo vetëm i hapjes së ekonomisë, por edhe i masave të menjëhershme të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave.

Rënia ekonomike pasqyroi kontraktimin e njëkohshëm të pothuajse të gjithë përbërësve të kërkesës agregate dhe të të gjithë sektorëve të ekonomisë, por kriza goditi në mënyrë më të veçantë konsumin privat dhe flukset tregtare, ku rënie shënoi si eksporti i mallrave, ashtu edhe ai i shërbimeve. Nga ana tjetër, konsumi dhe investimet publike erdhën në rritje, duke kompensuar pjesërisht rënien e kërkesës private.

***Së dyti, buxheti i vitit 2020 u ndryshua me 4 akte normative të Këshillit të Ministrave, të cilat kishin qëllim zbutjen e efekteve ekonomike e sociale të pandemisë shëndetësore COVID-19, duke siguruar mbështetje për sektorin e shëndetësisë, shtresat në nevojë, personat e larguar nga puna në biznese etj.***

Konkretisht, aktet normative që ndryshuan buxhetin 2020 janë si më poshtë:

- *Akti normativ nr.6, datë 21.3.2020*, i cili reduktoi të ardhurat e përgjithshme të buxhetit me 20 miliardë lekë, duke sjellë rritje të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky akt normativ lidhej direkt me pandeminë shëndetësore Covid-19 dhe kishte qëllim financimin e sektorit të shëndetësisë me pajisje, medikamente e materiale të tjera mjekësore të nevojshme, si dhe financimin e paketave sociale, në kuadër të saj.
- *Akti normativ nr.15/2020, datë 15.4.2020*, i cili nuk ndryshoi nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit, si dhe të deficitit buxhetor. Ky akt normativ mundësoi financimin me 7 miliardë lekë të shpenzimeve në kontingjencën për paketën sociale anti-COVID, duke përdorur si burim rialokimin e shpenzimeve buxhetore. Ai mundësoi edhe mbështetjen për biznesin, në formën e instrumentit të garancisë së re sovraane, në masën 15 miliardë lekë.
- *Akti normativ nr.28/2020, datë 2.7.2020*, i cili reduktoi të ardhurat e përgjithshme të buxhetit me 43 miliardë lekë dhe rriti shpenzimet e përgjithshme të buxhetit me 21 miliardë lekë kundrejt planit fillestar 2020. Kjo solli rritjen e deficitit buxhetor, i cili u parashikua në nivelin 8.4 për qind të PBB-së, nga 2.2 për qind e PBB-së që ishte sipas buxhetit fillestar. Rritja e shpenzimeve dhe rialokimi i tyre u orientua drejt financimit të investimeve në disa sektorë prioritarë të ekonomisë. Gjithashtu, ky akt normativ mundësoi edhe miratimin e garancisë sovraane në masën 15 miliardë lekë.
- *Akti normativ nr.34, datë 16.12.2020*, i cili nuk ndryshoi parametrat kryesorë makroekonomikë e fiskalë, siç janë deficitin buxhetor dhe borxhin publik, por krijoi më shumë mundësi për përballimin e situatës së pandemisë shëndetësore, dhënien e shpërblimit për pensionistët në fund të vitit, financimin e skemës së ndihmës ekonomike

e aftësisë së kufizuar, mbështetjen e investimeve më efikente dhe mbështetjen e pushtetit vendor.

***Së treti, efektet e pandemisë u ndjenë në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe vendi ynë qendroi pranë mesatares së vendeve të rajonit për sa i përket ritmit të rënies së PBB.***

Ekonomia e Ballkanit Perëndimor u reduktua mesatarisht me (- 3.3) për qind, nga një rritje prej 3.6 që ishte një vit më parë, ndikuar kryesisht nga pasojat e masave shtrënguese për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Rënia ekonomike në vendin tonë ishte pranë kësaj mesatareje.

Secili nga vendet në rajon ka strukturë ekonomike të ndryshme dhe masat e ndërmarra kishin diferenca. Por në përgjithësi, të gjitha vendet reagojnë në mënyrë të menjëhershme për të ndihmuar individët dhe bizneset. Rikujtojmë që vendi ynë është i vetmi vend i rajonit që po përballon dy goditje dhe jo vetëm pandeminë.

Si rezultat i rënies së aktivitetit ekonomik, rritja e vendeve të punës ishte negative në Ballkanin Perëndimor për vitin 2020. Rënia mesatare e punësimit në rajon qendroi 1.7 për qind, krahasuar me një normë rritjeje prej 2.0 për qind që ishte në vitin 2019.

Zhvillimet negative në sektorin e jashtëm, gjatë vitit 2020, u nxitën nga kolapsi i eksporteve të shërbimeve, në veçanti i turizmit, rënies së eksporteve të mallrave, si dhe rënies së të ardhurave nga remitancat në shumicën e vendeve të rajonit. Në të njëjtën kohë, edhe importet ranë me një ritëm të shpejtë, i cili në disa vende tejkaloi ndikimin e rënies së eksporteve dhe remitancave.

Deficitet e llogarisë korrente vazhduan të financohen kryesisht nga flukset hyrëse të IHD-ve, të cilat në lidhje me PBB-në u rritën në Mal të Zi, Kosovë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa ato ranë mesatarisht në të gjitha vendet e tjera të rajonit.

Borxhi i përgjithshëm i qeverisë u rrit në të gjitha vendet e rajonit gjatë vitit 2020, duke reflektuar rritjen e nevojave për financim dhe rënien e PBB-së nominale (me përjashtim të Serbisë). Në fund të vitit 2020, raporti i borxhit ishte më i larti në Malin e Zi (105 për qind e PBB-së), ndjekur nga Shqipëria (76.1 për qind) dhe Serbia (57.4 për qind).

***Së katërti, ndikimi i pandemisë ishte i ndjeshëm edhe në tregun e punës.***

Pandemia solli ndikimin më të madh në tregun e punës gjatë 3-mujorit të dytë 2020. Megjithatë, një pjesë e punësimit u rikuperua në gjysmën e dytë të vitit 2020, si rezultat i rihapjes graduale të ekonomisë dhe masave shtetërore për subvencionimin e pagave. Implikimet strukturore afatgjata në tregun e punës nuk janë shqetësuese.

Sipas Institutit të Statistikave, shkalla e papunësisë në tremujorin e fundit të vitit 2020 ishte

12.3 për qind, me një rritje të lehtë nga niveli 11.6 për qind që shënonte në fund të vitit 2019. Punësimi u kontraktua me rreth 1.8 për qind në krahasim me një vit më parë dhe në fund të vitit 2020 numri i të punësuarve në Shqipëri ishte 1,172,988 persona.

***Së pesti, mbështetja e biznesit ishte jo vetëm nëpërmjet ndihmës së drejtpërdrejtë me fonde buxhetore, por edhe nëpërmjet instrumenteve indirekte dhe lehtësive fiskale, të propozuara në qershor dhe të miratuara nga Kuvendi në korrik të vitit të mëparshëm.***

*Politika fiskale gjatë vitit 2020.*

Politika fiskale, në vitin 2020, është karakterizuar nga një thellim i mëtejshëm i lehtësive fiskale. Rritja e pragut të TVSH deri në 10 milionë lekë qarkullim vjetor dhe zero tatim fitimi për bizneset me qarkullim vjetor deri në 14 milionë lekë mundësojnë zero taksa për gati 86,000 biznese, të cilat kategorizohen si biznese të vogla e të mesme.

Me harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, jo vetëm u shty me një vit hyrja në fuqi e këtij ligji, por edhe u përcaktua një radhë e ndryshme e hyrjes në fuqi të fazave të fiskalizimit, ku marrëdhëniet me biznesin, apo ato që quhen me para në dorë (*cash*), të ishin të fundit dhe jo të parat.

*Taksat Vendore*

Ndryshimet ligjore të bëra gjatë vitit 2020, për taksat vendore, synuan mbështetjen e subjekteve të prekura nga pandemia COVID-19, si dhe rehabilitimin e komuniteteve të prekura si pasojë e fatkeqësisë natyrore. Konkretisht, investimet në kuadër të programeve të rindërtimit u përjashtuan nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas dispozitave të ligjit “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. Po ashtu, bizneset që ndërprejnë aktivitetin, si pasojë e masave të marra për përballimin e pandemisë, përfituan nga shtyrja e afateve të kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në vitin 2020.

Gjithashtu përgjatë vitit 2020 hynë në fuqi apo u miratuan edhe një sërë politikash lehtësuese ndaj biznesit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, siç ishin:

- Nxitja e sektorit të industrisë automotive, duke caktuar një normë të tatimit mbi fitimin 5 për qind për personat juridikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike në këtë industri;
- Promovimi i sportit, me qëllim rritjen e impaktit pozitiv të tij në shoqëri;
- Përjashtimi nga TVSH i automjeteve të reja vetëm me motorr elektrik, me synim mbrojtjen e mjedisit;

- Shtimi i dy kategorive të makinave që të përjashtohen nga taksa e makinave të përdorura e konkretisht: makinave të personave me aftësi të kufizuar dhe mjeteve të përdorura me interes historik dhe koleksionimi;
- Trajtimi tatimor i tatimit mbi pagën për të gjithë individët, që kanë më shumë se një pagë, duke tatuar pagën bruto, me qëllim vendosjen e një tatimi të drejtë dhe të unifikuar;
- Shtyrja e afatit të rivlerësimit të pasurive të paluajtshme, për t'u dhënë më shumë kohë qytetarëve që duan ta kryejnë këtë proces dhe për të rritur formalizimin e ekonomisë;
- Rritja e nivelit të akcizës për cigareve sipas kalendarit të parashikuar në ligjin aktual;

***Së gjashti, shpenzimet kapitale në një vit të vështirë nuk u shkurtuan, si dhe u mbështetën sektorët prioritarë.***

Shpenzimet buxhetore për investime në infrastrukturë, përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe infrastrukturën e zonave rurale, fondet në shëndetësi dhe mbështetjen e ndihmës ekonomike, si dhe fondet e programit të rindërtimit patën rritje dhe ndikim në këtë proces rikuperimi të shpejtë. Realizimi i investimeve në total ka qenë në nivele të larta, veçanërisht për financimin e brendshëm.

Rindërtimi i infrastrukturës së dëmtuar nga tërmeti i nëntorit të vitit 2019, u fokusua në sektorët e arsimit, infrastrukturës publike dhe strehimit.

Kjo strategji ndikoi edhe në rikthimin e treguesve të tregut të punës në trend pozitiv në tremujorin e tretë të vitit 2020.

*Mbështetja për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale ishte një prioritet i rëndësishëm i buxhetit 2020. Buxheti i dedikuar për menaxhimin e epidemisë dhe forcimin e sistemit shëndetësor ishte në vlerën 2.5 miliardë lekë. Kësaj shume i shtohen edhe rreth 507 milionë lekë ndihma, kryesisht nga organizata ndërkombëtare, për pajisje mjekësore, materiale mbrojtëse dhe medikamente.*

Gjatë vitit 2020, programi i ndihmës ekonomike u zgjerua, për të mbështetur me ndihmë ekonomike shtesë (dyfish) shtresat në nevojë që përfitojnë prej saj.

*Mbështetja e pushtetit vendor vijoi edhe në situatën e pandemisë Covid-19.*

Gjatë vitit 2020 pushteti vendor përballoi goditjet nga tërmeti dhe pandemia Covid-19, duke rritur kontributin e tij nga 5.02 për qind e PBB në vitin 2019, në 5.16 për qind të PBB në vitin 2020.

Megjithatë, efekti i pandemisë dhe ngadalësimi ekonomik sollën rënien e të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor, si më poshtë:

- Të ardhurat nga pushteti vendor u realizuan në masën 95 për qind, me një mosrealizim prej 1 miliardë lekësh.
- Shpenzimet për pushtetin vendor u realizuan në masën 97 për qind, me një mosrealizim prej 1.7 miliardë lekësh.

***Së shtati, deficitit fiskal në vitin 2020 arriti nivelin 6.9 për qind të PBB-së, më i ulët se kufiri ligjor prej 8.4 për qind e PBB-së, ndërsa borxhi publik arriti nivelin 76 për qind të PBB-së, me rritje me pothuaj 10 pikë përqindje nga viti 2019.***

Sidoqoftë, borxhi publik rezultoi më i ulët se pritshmëritë fillestare prej rreth 80 për qind të PBB, ndonëse u rrit për herë të parë pas katër vjetësh, për shkak të nevojës së huamarrjes së qeverisë për të përballuar efektet e krizës së pandemisë.

*Menaxhimi i borxhit publik.*

Në linjë me nevojat buxhetore, huamarrja u realizua nëpërmjet burimeve të brendshme dhe burimeve të huaja, përkatësisht në nivelin 97.3 për qind dhe 83.6 për qind të planit vjetor.

Në portofolin e borxhit të brendshëm është ulur pesha e borxhit që maturohet brenda një viti dhe pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme, duke mundësuar reduktimin e ekspozimit ndaj riskut të refinancimit dhe atij të normave të interesit.

Kostoja mesatare e portofolit të borxhit ka vijuar të ulët edhe përgjatë këtij viti.

Huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja do të plotësojë financimin e nevojshëm, duke kontribuar në uljen e presionit për hua në tregun e brendshëm dhe optimizimin e kostonë së borxhit.

Burimet kryesore të huamarrjes së huaj janë huatë me terma të buta ose pjesërisht të buta, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja, të konsideruara si prioritare nga qeveria, si edhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore, të akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare për të mbështetur reformat dhe politikat zhvillimore të vendit.



Pjesa e mbetur e financimit të huaj planifikohet të realizohet nëpërmjet burimeve private, ku si instrument huaje planifikohet të përdoret Eurobond-i.

### ***Së teti, politika fiskale është harmonizuar me politikën monetare.***

Në koordinim me stimulin fiskal, Banka e Shqipërisë vuri në jetë një paketë të plotë masash monetare, makroprudenciale dhe operacionale, të cilat synuan ruajtjen e likuiditetit në tregjet financiare, uljen e kostove të huamarrjes, vijimin e kreditimit dhe ruajtjen e një fluksi të pandërprerë të shërbimeve financiare. Për rrjedhojë, ndikimi i krizës në ekonomi rezultoi më i vogël nga sa pritej, duke dëshmuar si efektin pozitiv të masave shtetërore, ashtu dhe fleksibilitetin dhe rezistencën e ekonomisë dhe të sistemit financiar.

Rënia e kërkesës për mallra e shërbime u shoqërua me një nivel të ulët inflacioni, i cili ishte mesatarisht 1.6 për qind.

Në vitin 2020, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 6.6 për qind krahasuar me vitin 2019. Stoku i kredive në lekë shënoi rritje prej 7.3 për qind, ndërsa ai në valutë rritje prej 5.9 për qind krahasuar me muajin dhjetor të vitit të mëparshëm. Pjesa më e madhe e kontributit në rritjen e stokut total të kredisë, gjatë kësaj periudhe, ka ardhur prej kredive akorduar bizneseve.

Nëse qeveria nuk do kishte mbështetur me garancitë sovrane, duke akorduar një fond mbështetjeje në vlerën 260 milion lekë (nga i cili më shumë se 50 për qind është akorduar drejtpërdrejt bizneseve), performanca në stokun e kredive, por edhe performanca cilesore e huadhenies, nuk do të rezultonte në treguesit më pozitivë, që sot janë edhe më të mirë se para krizës.

Raporti i kredive me probleme zbriti në nivelin 8.2 për qind në muajin dhjetor, duke pasqyruar masat konkrete të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për reduktimin e tyre, si dhe përmirësimin e ambientit ekonomik dhe të gjendjes financiare të kredimarrësve.

## **V. Gjetjet dhe rekomandimet nga raporti i KLSH.**

KLSH ka audituar përputhshmërinë e hartimit, zbatimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2020. Relatorja evidentoi disa gjetje apo vlerësime të KLSH, siç janë:

***Së pari***, gjatë vitit 2020 është përmirësuar puna nga strukturat ekzekutive lidhur me zbatimin e detyrimeve të akteve ligjore e nënligjore. Ndikim pozitiv këtu ka pasur edhe përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor për menaxhimin e financave publike.

### ***Së dyti, respektimi i kufirit ligjor për kontratat e koncesionit/PPP.***

Kufiri i përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor për kontratat e koncesionit/PPP është respektuar. Sipas këtij ligji, shuma totale e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat, si rregull, nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.

Pagesat vjetore faktike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare apo PPP, rezultuan rreth 9.6 miliardë lekë ose 2.26 përqind e totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019. Vlera e tyre është brenda kufirit të pagesave prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, i cili përlllogaritet për rreth 21.3 miliardë lekë.

### **Rekomandime.**

Në përfundim të fjalës së saj, relatorja paraqiti disa rekomandime, si më poshtë:

- ***Së pari***, duhet të forcohet më tej puna e ministrive, institucioneve, njërive të vetëqeverisjes vendore dhe enteve publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, me qëllim përmirësimin e procesit të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit, si dhe rritjen e efektivitetit në menaxhimin e fondeve publike.
- ***Së dyti***, të gjitha institucionet buxhetore duhet të forcojnë punën për zbatimin korrekt të detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore. Kjo kërkesë bëhet më e mprehtë në drejtim të zbatimit të legjislacionit fiskal dhe të prokurimit publik, si fusha me risk më të lartë.
- ***Së treti***, duhet të rritet më tej bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave, KLSH-së dhe Kuvendit, për të bërë përmirësimet e nevojshme ligjore në fushën e buxhetit dhe të menaxhimit të financave publike.

Diskutimet në Komision u përqendruan, kryesisht, në realizimin e treguesve të buxhetit faktik 2020. Shumica e anëtarëve të Komisionit mbështeti vlerësimet e relatores.

## **VII. Përfundim.**

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2020” me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

**RELATORJA**

**Anila DENAJ**

**KRYETARI**

**Eduard SHALSI**